

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - GOVERNAT ZA ADMINISTRACIJU

Refuz/Refuz: 87
Data/Datum: 05 - 03 - 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.03.2026

Drejtorja e Administratës

Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

RAPORTI I PUNËS PËR FUNKSIONIMIN E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS PËR PERUDHËN
JANAR/DHJETOR 2025

Mars 2026

Përmbajtja e raportit.....	2
Hyrja.....	3
Struktura e raportit.....	3
Qëllimi i raportit.....	3
Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës.....	3
Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.....	3
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	11

Hyrje

Raporti i Punës për Funksionimin dhe aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa, për periudhën Janar/Dhjetor të vitit 2021 është i bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislativin e Komunës, si organi më i lartë i Komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të

datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka miratuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore, Buxhetin e Komunës, Raportin Përfundimtar Vjetor Financiar dhe Raportin Financiar gjashtëmujor.

Struktura e raportit

Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës synon të bëjë një vlerësim për progresin e arritur në përmbushjen e obligimeve ligjore, zbatimin e punëve dhe aktiviteteve, mbështetur në kompetencat e bazuara me ligj si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësiqe që lidhen me realizimin e kërkesave të ekzekutivit si dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës.

Struktura e raportit përfshin:

- Funksionimin e Kuvendit të Komunës;
- Funksionimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete;
- Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

Raporti përfshin periudhën Janar/Dhjetor 2025. Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga ekstraktet e procesverbaleve dhe aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës. Raporti shërben për nxjerrjen e një pasqyre dhe konkluzioneve më të hollësishme për funksionimin e Kuvendit të Komunës dhe hapave të cilët duhet të ndërmerren për përmirësime në të ardhmen.

Qëllimi i raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë dhe objektiv të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, për mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Komunës dhe mekanizmave tjerë përcjellës. Raporti pasqyron punën dhe aktivitetet e të zgjedhurve në mbrojtjen e interesave të qytetarëve si dhe shërben si mjet adekuat për rritjen e transparencës së organit më të lartë të komunës, i cili i ka dy funksione kryesore: 1. Funksionin vendimmarrës në shpërndarjen e buxhetit dhe 2. Funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të shpenzimeve.

Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës

1. Komiteti për Politikë e Financa, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, ka për detyrë shqyrtimin e politikave komunale dhe orientimeve strategjike të Komunës, shqyrtimin e aktiviteteve financiare të Komunës, Planin Vjetor të prokurimit publik, Planin Vjetor të auditimit të brendshëm dhe çështje tjera për të cilat jep rekomandime dhe nxjerr përfundime e konkluzione profesionale se si të veprohet në orientimin e politikave programore për zhvillimin ekonomik lokal,

rregullimin hapësinor dhe territorial, zhvillimin, rregullimin dhe strukturimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.

2. Komiteti për Komunitete, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Po ashtu, gjatë punës së tij, Komiteti për Komunitete, jep rekomandime për Kuvendin e Komunës lidhur me buxhetin, politikat programore për zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
3. Kuvendi i Komunës, si organ më lartë i Komunës dhe organ përfaqësues për subjektet politike, të cilat i përfaqësojnë qytetarët e Komunës dhe e kanë për obligim t'i mbrojnë interesat e tyre. Kuvendi i Komunës, bazuar në kompetencat e tij, propozimet e Ekzekutivit të Komunës, rekomandimet e dy Komiteteve të Përhershme: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, merr vendime për buxhetin dhe çështje tjera financiare, miraton aktet normative nga fusha e veprimtarisë së institucioneve lokale të pushtetit, miraton planet zhvillimore dhe rregullative, bën emërtimin e rrugëve e shesheve në territorin e Komunës dhe vendosë për shumë çështje tjera me interes lokal.

Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës

Janar 2025

1.Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.

2.Vendim i Kuvendit të Komunës

Për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1.4, nën paragrafit 1.4.3 të vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit z. Nexhmedin Rexhepi - Zëvendës Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 2 në Fushë-Kosovës, për rekrutimin në institucionin parashkollorë 'Gëzimi Yni' në Fushë-Kosovës, me anëtarin e ri z. Salih Jashanica - Drejtor i Shkollës fillore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu' në fshatin Bardh i Madh.

Mars 2025

1 Vendim për aprovimin e propozimit Nr. 171, të datës 25.02.2025 për rritjen e të hyrave vetjake në vitin 2024 dhe bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2024 për shpenzim në vitin 2025

1. Për rritjen e të hyrave vetjake të buxhetit të komunës për vitin 2024, në shumën e mjeteve financiare prej: 1,455,083.00€ dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2025, në nën - programet e kategorisë ekonomike të projekteve kapitale dhe
2. Për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2023 dhe 2024, si dhe rezerva e pa alokuar gjatë vitit 2024, në shumën e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, që arrin në shumën e përgjithshme prej: 2,917,489.16€, për shpenzim në vitin 2025, në nën -

programet dhe kategoritë ekonomike: mallëra e shërbime, subvencione e transfere dhe shpenzime kapitale të ndara.

2 Vendim i Kuvendit të Komunës

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 123, të datës 23.10.2024, për bartjen dhe transferimin e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e rezervës në kategorinë ekonomike të projekteve kapitale për vitin 2024, në shumën e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, të pa alokuara për shpenzim në vitin 2024.

3. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.

Prill 2025

Në mbledhjen e muajit prill nuk është marrë asnjë vendim.

Maj 2025 - mbledhja e parë

1 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016065/25, të datës 06.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Fidan Fehmi Reçica nga fshati Miradi e Epërme, i cili ka pësuar një fatkeqësi dhe është djegur 80% të sipërfaqes së trupit të tij, me Dg: 'Combustio termica, abrasio corneae', nga një materie kimike dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsye të natyrës së rëndë të lëndimeve trupore.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

2 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Propozimit me Nr. 440, të datës 06.05.2025 për caktimin e lokacionit dhe lejimin e vendosjes së 'Trafostatcionit Elektrik', në sipërfaqe të ndarë prej: S=26.9m², pjesë e Ngastrës Kadastrale me Nr. P-72514036-01422-0 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, nga sipërfaqja e përgjithshme e saj prej: S=1157 m², sipas numrit të lëndës Nr. 14-942-16451 të datës 08.05.2025, në funksion të dhënies në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029, në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës me destinim - infrastrukturë e komunës në të mirën e përgjithshme në pikën një të vendimit, është dhënia e pronës në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029 në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë në sipërfaqen e caktuar.
3. Kryerja e procedurave tjera për ndarjen gjeodezike dhe skicimin e sipërfaqes prej gjithsej: 26.9m² për vendosjen e 'Trafostatcionit Elektrik', pjesë e Ngastrës Kadastrale me Nr. P-72514036-01422-0 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, nga sipërfaqja e përgjithshme e kësaj ngastre kadastrale

prej: S=1157 m2, e evidentuar sipas numrit të lëndës Nr. 14-942-16451, të datës 08.05.2025, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Maj 2025 - mbledhja e dytë

1. Vendim i Kuvendit të Komunës

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinorë

Për fillimin e procedurës për ndryshimin - plotësimin të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020-2028, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

2. Vendim i Kuvendit të Komunës

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinorë

Për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues për pjesën e zonës urbane të Fushë-Kosovës, që përfshinë ngastrat kadastrale në mes të rrugës 'Gjergj Fishta' dhe rrugës së 'Uglarit' për blloqet e banimit: E5, E6, E7, E 18, E19, E20 dhe E21, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

3. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për shpalljen e veprimtarit, aktivistit, delegatit të Kuvendit të Kosovës dhe asambleistit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës z. Nazmi Avdi Kelmendi "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, është i lindur me datën 04.11.1957, në lagjen e Nakaradës në qytetin e Fushë-Kosovës, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje në Fushë-Kosovë, Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës.
2. I lartë cekuri në pikën një të këtij vendimi është veprimtarë dhe aktivistë me kontribut të çmuar që në fëmijërinë e tij, kryetar i Organizatës së Rinisë në Gjimnazin e Fushë-Kosovës, Sekretar në Bashkësinë Lokale në vitet 1978-1987, në vitet e tetëdhjeta 80-ta i angazhuar në kulturë dhe sport, referent për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në Fakultetin Teknik 1987-1990, delegat në Kuvendin e Kosovës që shpalli 'Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës', me datën 2 korrik 1990 dhe 'Kushtetutën e e Republikës së Kosovës' me 7 shtator në Kaçanik, asamblesitë në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës në tre mandate zgjedhore 2007-2017 dhe i dekoruar me 'Medaljen e Artë për Pavarësi', nga Presidenti Historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova dhe shumë mirënjohje e falënderime tjera nga institucione të ndryshme të vendit.

4. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Feti Mehdi Breznica nga fshati Miradi e Epërme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë në fazën e metastazës, me Dg: 'Adcmcccatkim metastas cerolo' dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsye të natyrës së sëmundjes së rëndë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Qershor 2025

1 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2026 - 2028, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2026 buxheti i komunës është në shumë prej: 26,803,586.00€;
 - 1.2 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumë prej: 28,359,191.00€ dhe
 - 1.3 Për vitin 2028 buxheti i komunës është në shumë prej: 29,765,823.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2026 - 2028, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

2 Vendim për ndryshim-plotësimin e Vendimit Nr. 47, të datës 23.05.2025, për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028

Aprovohet ndryshim - plotësimi për fillimin e revidimit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, në përputhje me raportet për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 të Drejtorisë së Planifikimit Urban.

3 Vendim për ndryshim-plotësimin e Vendimit Nr. 48, të datës 23.05.2025, për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028

Aprovohet ndryshim - plotësimi për korrigjimin e bazës ligjore të nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, pika 1.2.3, nenin 6, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.2, të vendimit Nr. 48, të datës 23.05.2025, për për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pjesën e zonës urbane të Fushë-Kosovës, që përfshinë ngastrat kadastrale në mes të rrugës 'Gjergj Fishta' dhe rrugës së 'Uglarit' për blloqet e banimit: E5, E6, E7, E18, E19, E20 dhe E21, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

4 Vendim për shqyrtimin publike të Projektit-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës 2025-2033.

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 948, të datës 19.06.2025, me të cilin shpallet në shqyrtim publik 'Projekt-Planin Zhvillimor Komunal i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033'.
2. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik me pjesën tekstuale dhe grafike dhe prezantimi i 'Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033', bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës dhe zgjat në afat prej 30 ditëve.
3. Projekt-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para përfundimit, të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

5 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. 627, të datës 17.06.2025, për shpalljen e vendeve të reja të punës dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 367,144.80€, për punësimin e punëtorëve shëndetësorë dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', në Fushë-Kosovë në vitin 2026, përmes procedurës së hapur të konkurimit publikë.

2. Paga për secilin të punësuar do të realizohet sipas Ligjit për Pagat e Sektorit Publik në fushën e shëndetësisë për vitin 2026, si në Propozimin me Nr. 627, të datës 17.06.2025.

6. Vendim i Kuvendit të Komunës

Për aprovimin e shpalljes së një qind e dy (102) vendeve - normave të reja të punës në arsim për vitin shkollorë 2025-2026, si në Propozimin me Nr. 625, të datës 17.06.2025

7. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komunitetit Ashkalinj nga Lista Ndryshe, duke e larguar z. Artan Asllani nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Qerim Gara në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës.

Korrik 2025

1 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0024560/25, të datës 16.07.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Nerxhivane Halimi nga Fushë-Kosova, e cila vuan nga sëmundja e rëndë me Dg: 'Aneurismae Aortae Thoraco Abdominalis' dhe i duhet trajtim shëndetësorë dhe rehabilitim pas operimit, operimi nuk bëhet në vendin tonë dhe është me kosto të lartë financiare.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.

2 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0024675/25, të datës 17.07.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për djalë të Lirim Rexhep Ismajli nga fshati Miradi e Poshtme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë me Dg: fillestare 'Cardiac arrest (1.46) Pneumonia aspirativa (J69.0) dhe diagnoza përfundimtare St post Cardiac arrest (1.46) Pneumonia aspirativa (J69.0)' dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm dhe rehabilitim shëndetësorë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.

3 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0020243/25, të datës 11.06.2025 dhe Kërkesës 06-580/02-0010742/25, të datës 12.03.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Muhamet Gani Berjani nga fshati Miradi e Epërme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë psiqike, me Dg: Skizofreni Paranoide 'F - 20.G (ICD-10)' dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm dhe rehabilitim shëndetësorë dhe është në gjendje të vështirë sociale.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.

Shtator 2025 - mbledhja e pare

1 Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0027034/25, të datës 04.08.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Skender Zenel Krasniqi nga fshati Miradi e Epërme, i cila vuan nga sëmundja e rëndë me Dg: 'Carcinoma skuamoze grada II - bronku principal sinister', të cilit i duhet trajtim i vazhdueshëm shëndetësorë për shërim dhe rehabilitim.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.

Shtator 2025 - mbledhja e dytë

1 Vendimi për buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026, në shumë të përgjithshme prej: 26,803,586.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe shtesa për 1124 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 10,600,536.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,057,122.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 428,400.€;
 - 1.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,708,751.00€ dhe
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,008,777.00€.
 2. Vlerësimet e hershme të cekura me kufijtë për buxhetin e planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2027 është në shumë të përgjithshme prej: 28,359,191.00€ dhe për vitin fiskal 2028 është në shumë të përgjithshme prej: 29,765,823.00€.

2. Vendim i Kuvendit të Komunës

Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2025 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 2,000,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, mallra e shërbime dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve.

3. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Miratohet Kërkesa Nr. Nr. 02-070/05-0031228/25, e datës 01.09.2025, për Kompensim Vjetor për Financimin e Ushqimit për Punëtorët e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Shuma e realizuar për Kompensim Vjetor për financimin e Ushqimit për punëtorët e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, është në shumën e mjeteve financiare vjetore bruto prej: 1,368.00€ dhe shumën e mjeteve financiare neto prej: 1,198.00€.

4. Vendim i Kuvendit të Komunës

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën tetë 8 vjeçare 2025-2033, në tekstin e mëtejme 'PZHK', si projekt-plan multi sektorial i cili përcakton caqet afatgjatë të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 84.7km².

5. Vendim i Kuvendit të Komunës

Për aprovimin e Propozimit Nr. 793, të datës 23.07.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri shkollorë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët, në fshatin Lismir të Komunës së Fushë-Kosovës, me ndarjen fizike nga Ngastra Kadastrale Nr. P-72514022-00662-0, e evidentuar në Certifikatën e Pronës të datës 22.07.2025, me sipërfaqe të përgjithshme S=4282m².

6. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029'.
2. Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029, e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për zhvillim ekonomik për periudhën pesë vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029.

7. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027'.
2. Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027', e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për avansimin e të drejtave të komuniteteve për periudhën tre vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027.

8. Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 713, të datës 22.07.2025 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2025 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 1.57€ për një metër katror në kategorinë e parë;

- 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 1.80€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
- 1.3 Taksa për rritjen e densitetit në infrastrukturë për kokë banori do të jetë 422.70€, me kosto për një metër katror në shumë totale prej: 8.45€ dhe
- 1.4 Taksa administrative për leje të rrënimt në shumë prej: 1.46€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe taksa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2025, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. 4003-2/25, të datës 14.06.2025.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.

- **Mbledhja inauguruese është mbajtur me datë 04.12.2025, ku e kanë dhënë betimin tridhjetë e një (31) anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe betimi i Kryetarit të Komunës z. Valon Prebreza.**

Vendim i Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e Propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjen e z. Vlonjat Hasani i lindur me datën 30.06.1988, me vendbanim në fshatin Miradi e Epërme - Bachelor i Shkencave Politike - Politolog, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të [Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029](#).
 2. Të drejtat dhe përgjegjësitë në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, i zgjedhuri do të filloj t'i ushtroj nga data 04.12.2025, sipas dispozitave ligjore e statutore dhe për punën e tij, i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
 3. Punët dhe detyrat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjigjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregulloren për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013.
- Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje.
 - Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje.
 - Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje.
 - Kuvendi i Komunës ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, prej tyre 9 të rregullta dhe mbledhjen inauguruese, janë marrë gjithsej 30 vendime, të publikuara në ueb-faqën e komunës janë njëzet e dy vendime, tetë janë rishqyrtuar, prej tyre shtatë janë lënë në fuqi pas rishqyrtimit në Kuvendin e Komunës dhe vetëm një vendim është shfuqizuar.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka patur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës dhe ekstraktet e procesverbaleve janë të publikuara në ueb-faqe.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkrjetari i Komunës. Sfidë ka qenë mos-publikimi i audioincizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nga ana e Ekzekutivit të Komunës, andaj meqë gjendja faktike ka vazhduar të jetë e tillë, ekstraktet e procesverbaleve nuk janë aprovuar nga ana e subjekteve politike të opozitës, me arsyetimin se mungon publikimi i audioincizimeve dhe shkelen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani

